Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA E TË DHËNAVE TË RRJETIT TË KONTABILITITETIT NË FERMË (FADN)

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

Analiza e të dhënave të Rrjetit të Kontabilitetit në Fermë (FADN)

Dhjetor, 2020

Parathënie

Të dhënat e paraqitura në këtë analizë janë të bazuara në anketën e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë (FADN) të udhëhequr nga MBPZhR, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore.

Financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim - BE, në vitin 2005 FADN filloi si një pilot projekt duke përfshirë 50 ferma. Ky rrjet u zgjerua në 159 ferma në vitin 2006, duke vazhduar me një rritje të numrit të fermave në 402 deri në vitin 2014. Nga viti 2015 deri më tani, mostra e FADN-së përfshin 1,250 ferma. Për mbledhjen e të dhënave të FADN-së, MBPZhR kontrakton operatorin ekonomik të përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit për periudha tre vjeçare.

Qëllimi kryesor i Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë (FADN) është përcaktimi i të ardhurave të fermave bujqësore, strukturës, prodhimit dhe shpenzimeve në ferma, me organizim sipas një sistemi të strukturuar të FADN-së dhe metodologjisë së përcaktuar nga BE-ja.

Sistemi i FADN-së është i obligueshëm për të gjitha shtetet anëtare të BE-së të cilat janë të obliguara të zhvillojnë sistemin uniform të FADN-së dhe të dorëzojnë raportet e standardizuara në Komisionin Evropian në baza vjetore. Raportet e FADN-së përdoren nga institucionet e BE-së kryesisht për qëllimin e analizimit të masave të politikës bujqësore. Të dhënat e mbledhura nga anketa e FADN-së janë konfidenciale dhe si të tilla duhet të publikohen vetëm si të dhëna të agreguara, të përmbledhura në një kategori të fermave.

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
FADN	Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermës
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NjB	Njësi blegtorale
NjVP	Njësia vjetore e punës
ROA	Kthimi në assets (Return on assets)
SBSh	Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar
SO	Standard Outputi
TF	Tipi i fermës

Tabela e Përmbajtjes

PARATHËNIE 2

SHKURTESAT 3

LISTA E TABELAVE 5

LISTA E FIGURAVE 5

HYRJE 6

1 PËRKUFIZIMET DHE METODOLOGJIA 7

1.1 Popullacioni i targetuar /Fusha e observimit 7

1.2 Madhësia e mostrës 9

2 STRUKTURA E FERMAVE 10

3 TË HYRAT DHE SHPENZIMET 13

4 TË ARDHURAT NË FERMË 16

5 ASETET DHE DETYRIMET 18

6 MBËSHTETJA 22

7 PËRFUNDIME 24

Lista e tabelave

Tabela 1: Lloji i fermës dhe nënllojet kryesore të tyre ... 8
Tabela 2: Madhësitë ekonomike të fermës ... 8
Tabela 3: Shpërndarja e fermave të përfshira në fushë të observimit ... 9

Lista e figurave

Figura 1: SBSh e përgjithshme dhe SBSh e marrë me qira si mesatare për fermë, ha ... 10
Figura 2: Njësitë blegtorale si mesatare për fermë ... 11
Figura 3: Fuqia punëtore e paguar dhe e papaguar si mesatare për fermë, % ... 11
Figura 4: Fuqia punëtore e papaguar sipas tipit të fermës ... 12
Figura 5: Fuqia punëtore e paguar sipas tipit të fermës ... 12
Figura 6: Rendimenti i grurit dhe misrit si mesatare për fermë, tonë për ha ... 13
Figura 7: Struktura e gjithsej Outputit ... 13
Figura 8: Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve ... 14
Figura 9: Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve sipas tipit të fermës ... 14
Figura 10: Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve, madhësia ekonomike në '000 ... 15
Figura 11: Të hyrat dhe shpenzimet si mesatare për fermë ... 16
Figura 12: Të ardhurat neto të fermës si mesatare për fermë, në € ... 16
Figura 13: Vlera e shtuar neto e fermës/NjVP si mesatare për fermë ... 17
Figura 14: Vlera e shtuar neto e fermës / NjVP sipas llojit të fermës ... 17
Figura 15: Vlera e shtuar neto e fermës/NjVP, madhësia ekonomike në '000 € ... 18
Figura 16: Vlera e aseteve dhe detyrimeve si mesatare për fermë ... 19
Figura 17: Vlera e aseteve sipas llojit të fermës si mesatare për fermë ... 19
Figura 18: Raporti i gjithsej detyrimeve / gjithsej aseteve ... 20
Figura 19: Raporti i gjithsej detyrimeve / gjithsej aseteve sipas tipit të fermës ... 20
Figura 20: Kthimi në asetet (ROA) ... 21
Figura 21 Kthimi në asetet (ROA) sipas tipit të fermës ... 21
Figura 22 Vlera e ekuitetit / kapitalit (net worth) si mesatare për fermë ... 22
Figura 23: Pagesat direkte si mesatare për fermë ... 23
Figura 24: Pagesat direkte për kultura bujqësore dhe blegtori ... 23

Hyrje

Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës (FADN), është një sistem përmes të cilit mblidhen të dhënat vjetore për rezultatet ekonomike të fermave. Bashkimi Evropian ka zhvilluar një gamë instrumentesh për vlerësimin e sektorit të bujqësisë. Një nga instrumentet që i ka ndihmuar BE-së në mbledhjen e informatave në lidhje me të hyrat dhe performancën ekonomike është FADN-ja. Të dhënat të cilat mblidhen përmes këtij instrumenti përfshijnë, por nuk janë të limituara në: vlerë të prodhimit të të korrurave, shitje dhe blerje, kosto të prodhimit, pasuri, detyrime, kuota të prodhimit dhe subvencione. Këto të dhëna i mundësojnë autoriteteve përkatëse që të hartojnë rekomandime që kontribuojnë në krijimin e politikave të favorshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Zhvillimi i mëtejshëm i FADN-së në Kosovë do të ofrojë një bazë për analizën dhe vlerësimin e përfitimit dhe efikasitetin e prodhimit në nivel ferme me mundësinë e ofrimit të këshillave të duhura për të përmirësuar produktivitetin dhe rentabilitetin e fermave. Për më tepër, bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura, vendimmarrësit dhe analistët e politikave bujqësore do të kenë mundësi për të vlerësuar konkurrencën e produkteve bujqësore kosovare në tregjet ndërkombëtare si dhe efektivitetin e masave të zbatuara të politikave.

Nga viti 2015 deri në vitin 2019, FADN-ja është zhvilluar me një mostër me madhësi prej 1,250 ferma. Metodologjia që zhvillohet në Kosovë është në harmoni me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 2015/220. Të dhënat e mbledhura nga anketa e FADN-së janë konfidenciale dhe si të tilla duhet të publikohen vetëm si të dhëna të agreguara, të përmbledhura në një kategori të fermave ose në fermat për një regjion apo zonë të caktuar. Në rrethana të veçanta është e lejuar që këto të dhëna të ju ofrohen për shërbim institucioneve të caktuara si rezultate anonime individuale për qëllime hulumtuese, si e drejtë e përcaktuar me ligjin e statistikave të Kosovës për qasjen në statistika zyrtare.

Ndonëse ka një metodologji universale të FADN-së, secili vend e modifikon atë marrë parasysh specifikat e vendit të tyre. Në Bashkimin Evropian, FADN aktualisht është duke mbledhur të dhëna nga më shumë se 80 mijë ferma që përfaqësojnë rreth 5 milion biznese në 28 shtete anëtare. Mostra e FADN-së përfaqëson rreth 90% të sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore dhe të prodhimit bujqësor në këto vende.

1 Përkufizimet dhe metodologjia

1.1 Popullacioni i targetuar /Fusha e observimit

Të gjitha fermat bujqësore të cilat janë marrë parasysh në shpërndarjen e mostrës për realizimin e anketës për FADN janë fermat të cilat e kalojnë pragun prej 2,000 € sa i përket standard outputit[1]. Këto ferma përfaqësojnë 87% të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore dhe 89% të njësive blegtorale[2].

Të dhënat mbi këto ferma janë marrë nga Regjistrimi i Bujqësisë që është zhvilluar nga ASK-ja në Nëntor të vitit 2014. Fermat në komunat veriore të cilat nuk kanë qenë pjesë e këtij regjistrimi nuk kanë qenë pjesë e anketës së FADN-së. Në bazë të këtyre të dhënave, në Kosovë janë 130,775 ferma, ndërsa 71,116 prej tyre kalojnë pragun prej 2,000 €, e të cilat ferma përbëjnë edhe fushën e observimit të FADN-së. Pra, në bazë të kritereve të paraqitura më lartë, veçanërisht në bazë të kriterit të standard outputit, popullacioni i targetuar për anketat e FADN-së është 71,116 ferma. Ky popullacion i targetuar përfshinë 54% të gjithsej numrit të fermave të regjistruara në Kosovë. Më poshtë në tabelën 1, janë të paraqitura 8 llojet e fermës dhe llojet kryesore apo nën llojet për secilin lloj të fermës, ndërsa në tabelën 2 janë të paraqitura 7 madhësitë ekonomike.

[1] **Standardi output** (SO) është gjithsej vlera e prodhimeve të fermës brenda një viti kontabël, e cila llogaritet në bazë të sipërfaqes dhe numrit të krerëve blegtoral duke i shumëzuar me koeficientët e parallogaritur.

[2] **Njësia blegtorale** (njb) është një njësi standarde e matjes, që mundëson agregimin e kategorive të ndryshme të kafshëve përmes përdorimit të koeficientëve specifik bazuar në rregullore të BE-së.

Tabela 1: Lloji i fermës dhe nënllojet kryesore të tyre

Lloji i fermës	Nënllojet kryesore të fermës
Të specializuara në kultura lavërtare	15. Të specializuara në drithëra, farëra të vajit dhe kultura proteinike
	16. Kultivim i përgjithshëm në fushë të hapur
	22. Të specializuara në hortikulturë (në fushë të hapur)
	23. Të specializuara në hortikulturë tjetër
Të specializuara në hortikulturë (serra)	21. Të specializuara në hortikulturë (serra)
Të specializuara në kultura shumëvjeçare	35. Të specializuara në vreshta
	36. Të specializuara në fruta dhe agrume
	38. Kombinime të ndryshme të kulturave të përhershme
Të specializuara në bagëti që kullosin	45. Të specializuara në prodhimtari qumështi
	46. Të specializuara në gjedhe – rritje dhe majmëri
	47. Të kombinuara gjedhe – qumësht, rritje dhe majmëri
	48. Dele, dhi dhe bagëti të tjera që kullosin
Të specializuara me granivore	51. Të specializuara në derra
	52. Të specializuara në shpezëtari
	53. Granivore të ndryshme të kombinuara
Kultura të përziera	61. Kultura të përziera
Ferma të përziera blegtorale	73. Blegtori e përzier, kryesisht bagëti që kullosin
	74. Blegtori e përzier, kryesisht granivore
Ferma të përziera me kultura dhe blegtori	83. Të kombinuara lavërtare – bagëti që kullosin
	84. Kultura dhe blegtori të përziera

Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Në tabelën më poshtë, janë të paraqitura 7 madhësitë ekonomike të fermave të FADN-së. Për shkak se në madhësinë më të madhe ≥ 500,000 mund të ndodh që nuk ka mjaft ferma, për të ruajtur konfidencialitetin e këtyre fermave është aplikuar rregulli që nëse janë më pak se 5 ferma të cilat i përkasin një tipi të fermës nga tabela 1, atëherë këto ferma bashkohen me grupin më të afërt dhe të dhënat paraqiten si të bashkuara.

Tabela 2: Madhësitë ekonomike të fermës

('000)	Madhësia ekonomike
2 - <4	2,000 - <4,000
4 - <8	4,000 - <8,000
8 - <25	8,000 - <25,000
25 - <50	25,000 - <50,000
50 - <100	50,000 - <100,000
100 - <500	100,000 - <500,000
≥500	≥ 500,000

Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

1.2 Madhësia e mostrës

Për të pasur një mostër të fermave bujqësore sa më përfaqësuese, është vendosur që afërsisht 2% e fermave të konsiderohen si pjesë e anketës së FADN-së ose më saktësisht gjithsej 1,250 ferma. Duke marrë parasysh që një numër i fermave refuzojnë për t'u përfshirë në rrjet për arsye të ndryshme, atëherë për secilën njësi ekonomike janë përfshirë afërsisht edhe nga 2 ferma rezervë. Më poshtë është paraqitur shpërndarja e të gjitha fermave të përfshira në fushë të observimit, të ndara sipas llojit të fermës dhe madhësisë ekonomike.

Tabela 3: Shpërndarja e fermave të përfshira në fushë të observimit

	Madhësia Ekonomike, '000 €							
Lloji i fermës	**2 - <4**	**4 - <8**	**8 - <25**	**25 - <50**	**50 - <100**	**100 - <500**	**≥500**	**Gjithsej**
Kultura lavërtare	6,914	3,835	3,095	983	404	117	3	15,351
Hortikulturë (serra)	76	105	194	117	93	51	1	637
Kultura shumëvjeçare	877	945	1,028	193	63	20	4	3,130
Të specializuara në bagëti që kullosin	4,937	2,631	2,145	447	95	14	1	10,270
Granivore	1,026	779	314	43	43	69	7	2,281
Kultura të përziera	1,551	1,491	1,233	194	48	15	0	4,532
Të përziera blegtorale	3,769	2,522	1,225	120	18	4	0	7,658
Të përziera me kultura dhe blegtori	11,395	8,856	5,991	817	166	32	0	27,257
Gjithsej	**30,545**	**21,164**	**15,225**	**2,914**	**930**	**322**	**16**	**71,116**

Burimi: ASK, Regjistrimi i Bujqësisë 2014, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Nga tabela e mësipërme vërehet që fermat bujqësore më së shumti janë të koncentruara në kategorinë e fermave të përziera me kultura dhe blegtori (38% e të gjitha fermave komerciale). Ndërsa, sa i përket madhësisë së fermës, 30,545 ferma klasifikohen si ferma me SO prej 2,000–<4,000 €. Nga këto të dhëna, shihet që vetëm 1% e fermave në Kosovë janë të specializuara në hortikulturë - serra (në këtë tip të fermës bëjnë pjesë vetëm fermat që kultivojnë perime në serra) dhe 52 ferma të kësaj kategorie kanë arritur të kenë standard outputin më të lartë se 100,000 €.

Për të pasur një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse për përcaktimin e mostrës së FADN-së, është gjeneruar devijimi standard për secilën kategori. Fermat e fushës së observimit të shpërndara sipas kategorive janë shumëzuar me devijimin standard për të gjeneruar një shpërndarje optimale të fermave. Pra, në këtë rast është përdorur metoda e shpërndarjes optimale në mënyrë që në mostër të mos përfshihen shumë ferma të vogla duke qenë se numri i tyre është më i madh, por të ketë një përfshirje më të madhe të fermave me madhësi ekonomike më të madhe.

2 Struktura e fermave

Në Kosovë, shumica e fermave janë të vogla, kryesisht ferma ekzistenciale dhe gjysmë-ekzistenciale. Sipas të dhënave të FADN-së për periudhën 2015-2019, sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (SBSh) ka pasur ndryshime. Në vitin 2015 dhe 2016, SBSh ishte më e madhe, ndërsa më e vogël ishte në vitin 2018 dhe 2019. Sa i përket SBSh-së të marrë me qira, më e madhja ishte në vitin 2019, ku krahasuar me vitin paraprak, kishte 18% rritje.

Figura 1: SBSh e përgjithshme dhe SBSh e marrë me qira si mesatare për fermë, ha



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Njësia Blegtorale (NjB) është një njësi standarde e matjes, që mundëson agregimin e kategorive të ndryshme të kafshëve duke u bazuar në koeficientët specifik të llogaritur në bazë të rregullores së BE-së. Përmes kalkulimit të NjB-ve, mundësohet krahasim më i lehtë i kafshëve gjatë viteve dhe ndërmjet vendeve të ndryshme. Më poshtë janë paraqitur njësitë blegtorale si mesatare për një fermë në Kosovë. Sipas kësaj figure vërejmë se nuk ka pasur aq shumë ndryshime në NjB gjatë periudhës '15-'19, ku më e larta ishte në vitin 2016, ndërsa mesatarja sillet rreth 3 NjB.

Figura 2: Njësitë blegtorale si mesatare për fermë

Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Sipas të dhënave të FADN-së, një përqindje shumë e vogël e fuqisë punëtore paguhet. Në figurën më poshtë, vërejmë se në vitin 2019, përqindja e fuqisë punëtore të paguar është më e lartë krahasuar me vitet paraprake, ndërsa mesatarja e fuqisë punëtore të papaguar për periudhën '15-'19 sillet rreth 93%.

Figura 3: Fuqia punëtore e paguar dhe e papaguar si mesatare për fermë, %



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Në dy figurat në vijim, paraqitet pjesëmarrja e fuqisë punëtore të paguar dhe papaguar sipas tipit të fermës. Nëse analizojmë fuqinë punëtore të papaguar, vërejmë se fermat e përziera blegtorale dhe ato të përziera me kultura dhe bagëti kanë përqindjen më të lartë të fuqisë punëtore të papaguar, ndërsa përqindjen më të ulët e kanë fermat e specializuara në hortikulturë (serra) dhe kultura shumëvjeçare.

Figura 4: Fuqia punëtore e papaguar sipas tipit të fermës



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Në Kosovë, fuqia punëtore e paguar si mesatare për fermë është në përqindje shumë më të vogël, posaçërisht tek fermat e specializuara në kultura dhe bagëti, të përziera blegtorale dhe të specializuara në bagëti që kullosin. Përqindjen më të lartë të fuqisë punëtore të paguar e kanë fermat e specializuara në hortikulturë (serra) dhe të specializuara në kultura shumëvjeçare.

Figura 5: Fuqia punëtore e paguar sipas tipit të fermës



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Figura në vijim shfaq të dhënat lidhur me rendimentin e grurit dhe misrit për periudhën '15-'19. Rendimenti i grurit përveç vitit 2018 që ishte më i ulët, vitet tjera ishte pothuajse i njëjtë. Misri, në anën tjetër, rendimentin më të lartë prej 4.11 tonë për hektar e kishte në vitin 2018, ndërsa për vitet tjera mesatarja sillet rreth 3.75 tonë për hektar.

Figura 6: Rendimenti i grurit dhe misrit si mesatare për fermë, tonë për ha



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

3 Të hyrat dhe shpenzimet

Në këtë kapitull paraqiten të dhënat lidhur me të hyrat dhe shpenzimet në ferma në baza vjetore për periudhën '15-'19. Figura më poshtë përmban të dhënat për outputin e prodhimeve bimore, outputin e blegtorisë dhe produkteve blegtorale, si dhe outputin tjetër. Këto së bashku e përbëjnë gjithsej outputin e fermës. Në këtë figurë vërejmë se nga viti 2015 deri në vitin 2018, në përgjithësi ka pasur vazhdimisht rënie të outputit, ndërsa në vitin 2019, gjithsej outputi shënoi rritje për 25%.

Figura 7: Struktura e gjithsej Outputit



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Në vazhdim është paraqitur raporti midis outputit dhe inputeve i cili tregon efikasitetin e prodhimit. Ky raport në mes të Outputit dhe inputit tregon se për çdo 1 € të shpenzuar, sa vlerë është krijuar. Sa më i lartë raporti, aq më produktive është ferma. Sipas figurës më poshtë, për periudhën 2015-2019, raporti më i larti ishte në vitin 2017 i cili ishte 1.37

, si dhe dy vitet paraprake, ndërsa vitin 2018 dhe 2019, raporti ishte më i ulët që tregon se inputet ishin të larta ndërsa outputi jo aq i lartë.

Figura 8: **Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve**



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Nëse analizojmë raportin midis outputit dhe inputeve sipas tipit të fermës, vërejmë se në përgjithësi fermat e specializuara në hortikulturë (serra) janë më produktive, pasuar nga fermat e specializuara në bagëti që kullosin si dhe të tjera që varësisht nga viti, kanë raportin më të lartë ose më të ulët.

Figura 9: **Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve sipas tipit të fermës**



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Këtë raport midis outputit /inputit mund ta analizojmë edhe sipas madhësive ekonomike ku të dhënat shfaqen në figurën më poshtë. Për tre vitet gjatë periudhës '15-'19, madhësia ekonomike 50<100 rezulton të jetë me raport më të lartë, rrjedhimisht më produktive, kurse në vitin 2017, raport më të lartë kishin fermat e madhësisë 25<50 dhe në vitin 2018, fermat me madhësi ≥100.

Figura 10: Raporti i gjithsej Outputit / Inputeve, madhësia ekonomike në '000



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Figura në vijim përmban të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet si mesatare për fermë. Sa i përket të hyrave, shohim se mbështetja ishte pak më e lartë në vitin 2015 dhe 2016, ndërsa vlera e outputit kishte luhatje gjatë periudhës në fjalë, ku vlera më e lartë ishte në vitin 2019. Nëse analizojmë strukturën e shpenzimeve, pjesën më të madhe e zë konsumi i ndërmjetëm i cili paraqet vlerën e mallrave dhe shërbimeve të konsumuara si inpute gjatë procesit të prodhimit, vlerë që po ashtu ishte më e larta në vitin 2019. Shpenzimet tjera përfshijnë zhvlerësimin, shpenzimet për veprimtarinë e fermës, si dhe faktorët e jashtëm.

Figura 11: Të hyrat dhe shpenzimet si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

4 Të ardhurat në fermë

Në këtë kapitull paraqiten të dhënat lidhur me të ardhurat në ekonomitë bujqësore. Sipas të dhënave të grumbulluara nga anketa e FADN-së, rezulton se për periudhën 2015-2019, mesatarja e të ardhurave neto në fermë është rreth 2,420 €. Vlera më e lartë e të ardhurave ishte në vitin 2015, ndërsa vitet tjera ka pasur rënie, përveç në vitin 2019 ku të ardhurat shënuar rritje për 37% krahasuar me vitin 2018.

Figura 12: Të ardhurat neto të fermës si mesatare për fermë, në €



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Sa i përket vlerës së shtuar neto për njësi vjetore të punës, mesatarja për periudhën 2015-2019 ishte 2,380 €. Vlera më e lartë ishte në vitin 2016 ndërsa ajo më e ulëta në vitin 2018. Rritje të lehtë kishte në vitin 2019 ku krahasuar me vitin 2018 ishte 4% më e lartë.

Figura 13: Vlera e shtuar neto e fermës/NjVP si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat lidhur me vlerën e shtuar neto të fermës për njësi vjetore të punës në bazë të tipeve të fermës. Në përgjithësi, gjatë periudhës 2015-2019, vlera më e lartë vërehet tek fermat e specializuara në kultura shumëvjeçare, hortikulturë (serra), granivore, pasuar me tipet tjera me vlerë më të ulët.

Figura 14: Vlera e shtuar neto e fermës / NjVP sipas llojit të fermës



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Nëse e analizojmë vlerën e shtuar neto/NjVP sipas madhësisë ekonomike të fermës, në figurën në vijim shohim se në përgjithësi, vlera më e lartë ishte tek madhësia më e madhe ekonomike (≥100), përveç në vitin 2019, ku madhësia 50<100 kishte vlerën e shtuar neto/NjVP më të lartën.

Figura 15: Vlera e shtuar neto e fermës/NjVP, madhësia ekonomike në '000 €



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

5 Asetet dhe detyrimet

Figura në vijim përmban të dhëna për gjithsej vlerën e aseteve dhe detyrimeve si mesatare për fermë. Gjatë periudhës '15-'19 nuk kishte ndryshime të theksuara në vlerë të aseteve. Vlera më e lartë ishte në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 kishte rënie për 7%. Detyrimet në anën tjetër, janë shumë më të vogla për fermat në Kosovë, ku mesatarja gjatë periudhës në fjalë ishte 266 €. Vlera e detyrimeve në përgjithësi pati rritje të vazhdueshme përgjatë periudhës '15-'19, përveç në vitin 2017 ku u shënua rënie e detyrimeve.

Figura 16: Vlera e aseteve dhe detyrimeve si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Nëse e analizojmë vlerën e aseteve sipas tipit të fermës shohim se fermat e specializuara në kultura të përziera, kultura shumëvjeçare, kultura lavërtare janë ndër tipet e fermave me vlerë më të lartë të aseteve, pasuar nga tipet tjera.

Figura 17: Vlera e aseteve sipas llojit të fermës si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Figura e radhës paraqet raportin e borxhit në përqindje ose i gjithsej detyrimeve dhe gjithsej aseteve. Ky raport ishte më i larti në vitin 2019 që do të thotë se në këtë vit fermat kishin vlerë më të lartë të detyrimeve në raport me asetet.

Figura 18: Raporti i gjithsej detyrimeve / gjithsej aseteve



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Sa i përket raportit mes detyrimeve dhe aseteve sipas tipit të fermës, gjatë periudhës '15-'19 ky raport ishte më i lartë për fermat e specializuara në granivore, hortikulturë (serra) dhe kultura shumëvjeçare që do të thotë që nga të gjitha tipet e fermës këto ferma kanë nivelin e detyrimeve më të lartë në raport me asetet, ndërsa raporti i borxhit më i ulët qëndron tek fermat me kultura lavërtare dhe të përziera me kultura dhe blegtori.

Figura 19: Raporti i gjithsej detyrimeve / gjithsej aseteve sipas tipit të fermës



Figura më poshtë paraqet të dhënat lidhur me kthimin në asete apo raportin e të ardhurave neto me asetet. Kthimi në asete (ROA) matë efektivitetin e aseteve të ekonomive bujqësore në gjenerimin e gjithsej të ardhurave. Ky raport ishte mesatarisht rreth 1.5% në periudhën '15-'19, përveç vitin 2018 që ishte më i ulët rreth 1%.

Figura 20: Kthimi në asetet (ROA)



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Sa i përket kthimit në asete sipas tipit të fermave, në figurën më poshtë vërejmë se përveç vitit 2018, fermat e specializuara në hortikulturë (serra) shënuan kthimin më të lartë në asete gjatë kësaj periudhe, e që tregon se këto ferma ishin më efikase në gjenerimin e të ardhurave nga pasuritë e tyre. Pas fermave të specializuara në hortikulturë, kthimin më të madh në asete e kishin kulturat shumëvjeçare për tre vite me radhë, ndërsa në vitin 2018, raportin më të lartë e kishin fermat e specializuara në granivore.

Figura 21 Kthimi në asetet (ROA) sipas tipit të fermës



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Në vijim është paraqitur vlera e ekuitetit si mesatare për fermë për periudhën '15-'19. Gjatë kësaj periudhe vërehen ndryshime të vogla, ku mesatarja sillet rreth 178,350 €. Vlera më e lartë ishte në vitin 2018 (186,824 €) kurse më e ulëta në vitin 2017 në vlerë prej 171,679 €.

Figura 22 Vlera e ekuitetit / kapitalit (net worth) si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

6 Mbështetja

Për të zhvilluar sektorin e bujqësisë, MBPZhR çdo vit mbështet fermerët përmes pagesave direkte dhe granteve. Programi për Pagesat Direkte si objektiva parasheh: rritjen e konkurrueshmerisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor; rritjen e të hyrave në fermë; rritjen e rendimentit; zvogëlimin e importit; përmirësimin e cilësisë së prodhimit; zvogëlimin e shpenzimeve të prodhimit; rritjen e kapaciteteve përpunuese; dhe intensifikimin e ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

Në këtë kapitull paraqiten të dhënat lidhur me mbështetjen, konkretisht pagesat direkte. Figura e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me vlerën e pagesave direkte si mesatare për fermë gjatë periudhës '15-'19. Tre vitet e para gjatë kësaj periudhe kishin vlerë më të madhe ku më e larta ishte në vitin 2016 në vlerë prej 365 €. Në vitin 2018 ishte vlera më e ulët (307 €) kurse në vitin 2019 vërehet një rritje e lehtë prej 3% krahasuar me vitin paraprak.

Figura 23: Pagesat direkte si mesatare për fermë



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

Nëse i analizojmë pagesat direkte sipas kategorisë së kulturave dhe blegtorisë, vërejmë se pagesat direkte për kultura përfaqësojnë rreth dy të tretat e gjithsej pagesave direkte. Në vitin 2019 vërehet një rritje e pjesëmarrjes së blegtorisë në gjithsej pagesat direkte.

Figura 24: Pagesat direkte për kultura bujqësore dhe blegtori



Burimi: FADN, DAESB-MBPZHR

7 Përfundime

Të dhënat e FADN-së për periudhën 2015-2019 tregojnë që shumica e fermave në Kosovë janë të specializuara në kultura lavërtare edhe pse vlera neto e shtuar e fermës për NjVP në këtë kategori nuk është shumë e lartë, sidomos nëse i krahasojmë me fermat e specializuara në hortikulturë (serra) dhe në kultura shumëvjeçare.

Një nga indikatorët kryesor që paraqet interes të veçantë si për fermerët ashtu edhe për palët tjera të interesit është profitabiliteti i fermave. Në bazë të të dhënave të mbledhura, fermat më fitimprurëse bujqësore në Kosovë për vitin 2019, nëse i krahasojmë sipas vlerës së shtuar neto për NjVP janë fermat e specializuara në hortikulturë (serra), ndërsa vitet tjera ku vlera për NjVP është prej 3,484 €. Pra, ky sektor paraqet një potencial të konsiderueshëm që të zgjerohet më tej, meqë profitabiliteti është më i lartë krahasuar me sektorët tjerë. Pas fermave të specializuara në hortikulturë (serra), gjatë periudhës 2015-2019, me vlerë të shtuar neto për NjVP më të lartë, renditen fermat e specializuara në granivore, fermat e specializuara në kultura shumëvjeçare, fermat e specializuara në bagëti që kullosin, dhe të tjera.

Në bazë të rezultateve të nxjerra nga anketa e FADN-së, arrijmë në përfundim që prodhimtaria në Kosovë është mjaft e ulët, sidomos në krahasim me vendet e BE-së. Sipas deklaratave të fermerëve, arsyeja e prodhimtarisë së ulët është mungesa e sistemit të ujitjes, makineria dhe teknologjia e vjetër e punës, mungesa e njohurive për praktikat e reja të punës në bujqësi si dhe kushtet e pafavorshme klimatike.